



Republic of Kosovo
Ministry of Foreign Affairs
Diplomatic Academy



GEORGE C. MARSHALL
European Center for Security Studies

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES TË

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QENDRA EVROPIANE PËR STUDIME TË SIGURISË GEORGE C. MARSHALL¹

1. **QËLLIMI:** Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është të vendos bazën për një bashkëpunim akademik dhe për aktivitete tjera për avancimin e bashkëpunimit në mes të Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës (Akademia Diplomatike) dhe Qendrës Evropiane për Studime të Sigurisë George C. Marshall (CGMC), në Gjermani.
2. **FUSHËVEPRIMI:** Ky MiM zbatohet për GCMC-në dhe Akademinë Diplomatike dhe përcakton kornizën për një mirëkuptim dhe bashkëpunim të ndërsjellët.
3. **HISTORIKU:** Në vazhden e kontakteve dhe vizitave të fundit, Akademia Diplomatike dhe udhëheqësit diplomatik të GCMC-së kanë identifikuar fushat e interesit të përbashkët në mes dy institucioneve të tyre dhe kanë shprehur dëshirën të krijojnë lidhje më formale me anë të MiM. Qëllimi i këtij bashkëpunimi qëndron në krijimin e kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta, stimulimin e hulumtimit më cilësi të lartë dhe bursa në mes të palëve, dhe të shqyrtoj mundësitë e formave tjera të bashkëpunimit në kuadër të fushëveprimit të mirëkuptimit të ndërsjellët të këtij memorandumi, duke mundësuar CGMC-së që të përfitoj nga perspektiva unike e studiuesve kryesorë të Akademisë Diplomatike mbi këto çështje, si dhe që Akademia Diplomatike të përfitoj nga ekspertiza unike regjionale dhe shumëkombëshe e CGMC-së.
4. **AUTORITETI:** Ky MiM nuk është ligjërisht obligativ dhe nuk krijon asnjë të drejtë veprimi, goftë publik apo privat. Ky MiM nuk e detyron asnjë palë të ofroj fonde apo burime tjera. Ky MiM nuk ndryshon apo zëvendëson protokollin ekzistues për përzgjedhjen apo verifikim e personelit vizitues tek ose nga cilado palë.
5. **MIRËKUPTIMI I NDËRSJELLË**

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGINALE!

Palët kanë për qëllim të marrin në konsideratë idetë e mëposhtme sipas termeve të MiM si bazë për një bashkëpunim në të ardhmen:

- a. Programet e vizitave dhe seminareve të organizuara nga institucionet nikoqire mbi temat dhe tematikat me interes të ndërsjellë.
- b. Këmbime ose vizita të studiuesve të secilës palë për qëllime të hulumtimit, bursave dhe mësimdhënies.
- c. Këmbime të pjesëmarrësve dhe/ose studentëve vizitues, që iu nënshtrohen kërkesave dhe tarifave për pranim, aty ku është e zbatueshme
- d. Studime dhe hulumtime, si dhe shkëmbime të informatave mbi publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë dhe shkëmbime të revistave shkencore akademike dhe publikime tjera me interesit të ndërsjellë që janë publikuar në gjuhën angleze.
- e. Shkëmbim të informatave dhe të pikëpamjeve në lidhje me trendët ndërkombëtare dhe avancimet në trajnime, studime dhe hulumtime në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhëniet e jashtme ekonomike, shkencat politike dhe fushat tjera relevante, si dhe mjetet e ndërlidhura me e-learning (mësim elektronik).
- f. Zgjerimi i qasjes në librarinë digjitale të fakultetit vizitues dhe studentëve nga palët përkatëse gjatë kohëzgjatjes së vizitave të tyre.

Detajet e projekteve specifike në pajtim me këtë MiM do të trajtohen në mes të Palëve sipas rastit.

6. **FINANCIMI:** Të gjitha obligimet dhe shpenzimet nga Palët do t'i nënshtrohen proceseve të tyre përkatëse buxhetore dhe fiskale dhe disponueshmërisë së fondeve në pajtim me të gjithë ligjet, rregulloret dhe politikat e zbatueshme për këtë qëllim. Palët pranojnë se nuk ka aludime, premtime, ose garanci që fondet do të jenë në dispozicion për ndonjë aktivitet të veçantë. Palët do të vazhdojnë të paguajnë pagat e personelit të tyre akademik gjatë këmbimit me institucionet e tyre partnere. Institucioni pranues nuk do të paguaj asnjë pagë për personelin vizitues akademik.

7. **ZGJIDHJA E KONTESTEVE:** Mosmarrëveshjet në mes të palëve që vijnë ose janë në lidhje me këtë MiM do të zgjidhen vetëm me konsultime në mes të palëve dhe nuk do t'i referohen asnjërës palës së jashtme apo forumi të jashtëm.

8. **PIKA KONTAKTUESE:** Ky MiM do të udhëhiqet së bashku nëpërmjet zyrave në vijim, të cilat do të përfaqësojnë Palët gjatë zbatimit të kushteve të kësaj marrëveshjeje:

Qendra George C.Marshall
Dekan, CISS

Akademia Diplomatike e Ministrisë
Jashtme e Republikës së Kosovës

Njësiti 24502
APO AE 09053

Adresa
Rr. Luan Haradinaj, 10000

9. NDRYSHIMET, NDËRPRERJA DHE KOHËZGJATJA

- a. Të gjitha aktivitetet e Palëve në pajtim me këtë MiM, do të kryhen në frymë të bashkëpunimit dhe me pëlqim dhe miratim të të dyja Palëve.
- b. Ky MiM do të hyj në fuqi me nënshkrimin e palës së fundit dhe do të mbes në fuqi deri në ndërprerjen përmes njoftimit me shkrim të një apo më shumë përfaqësuese të autorizuar të palëve.
- c. Cilado palë mund të ndërpresë këtë MiM me anë të një njoftimi paraprak prej 30 ditësh me shkrim të palës tjetër. Njoftim i tillës do t'i nënshtrohet konsultimeve të menjëhershme të Palëve që të vendosin mbi veprimin e duhur në të ardhmen. Në rastin e ndërprerjes së tillë, do të zbatohen rregullat në vijim:
 1. Pala që e ndërpret marrëveshjen do të vazhdoj pjesëmarrjen qoftë financiare ose tjetër, sipas nevojës për të përmbushur cilëndo obligim të shkaktuar nga pala tjetër.
 2. Përderisa nuk bie ndesh me paragrafin më lartë, secila Palë do të paguaj koston që e shkaktohet si rezultat i ndërprerjes.
- d. Përveç nëse parashihet më ndryshe, ky MiM mund të ndryshohet me pëlqim të ndërsjellë me shkrim nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit më poshtë, të cilët janë të autorizuar në mënyre të duhur për këtë, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

ARRITUR në Prishtinë më _____ të _____ 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze, që të dyja njëlloj autentike.

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme
të Republikës së Kosovës

Enver Hoxhaj
Ministër i Punëve të Jashtme

LTG (i pensionuar) Keith W. Dayton,
Drejtor

Data: 24 Maj 2014

Data:

Për Qendrën Evropiane të Studimeve të
Sigurisë George C. Marshall